



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.1.	RREZIQET FIZIKE
Nën-tema 2.1.8.	RREZATIMI ARTIFICIAL OPTIK
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Ligji Nr.04/L-161/2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.09/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës.
Shkurtesa:	• MPSM – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr.04 / L-161 për "Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsyet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të rrezatimit artificial optik.
Përdorimi i listës së kontrollit:	Nëse përgjigjeni "Po" në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni "Jo" bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika e kontrollit	Po	Jo	Vërejtje për zbatim
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<i>* Meqenëse bëhet fjalë për vetë inspektim, apo vetëvlerësim të situatës në subjektin tuaj nga rreziqet fizike – rrezatimi artificial optik, do të ishte mirë që ekipi i inspektimit paraprakisht ta ketë në shqyrtim dokumentin e vlerësimit të riskut, atëherë do të ketë njohuri të afërta me rreziqet dhe masat e përcaktuara, të cilat duhet apo është dashur të ndërmerren nga punëdhënësi për mënjanimin, respektivisht minimizimin e tyre.</i>			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	<i>* Gjatë vizitës në vendpunishte / vendin e punës, duhet t'i kushtoni vëmendje të punësuarve që janë të ekspozuar në vende të punës me rreziqe nga rrezatimi artificial optik duke ju sqaruar anët negative nga përdorimi i pajisjeve të cilat janë burim i këtyre rrezatimeve.</i>			

	<i>* Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshilloni për të drejtat e tyre sipas legjislacionit.</i>			
1.	A bëhet vlerësimi i nivelit të ekspozimit? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 5			
2.	A është në disponim dokumenti i vlerësimit të ekspozimit tek punëmarrësit? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 5 • <i>Ky dokumentacion prefshin të gjithë informacionin dhe të gjitha faktet e përcaktuara në rregullore.</i>			
3.	A identifikon vlerësimi i riskut masat të cilat duhet të ndërmerren? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 5 • <i>Masat e përcaktuara duhet të jenë kompatible me rrezikun e identifikuar, sigurisht edhe me nivelin e riskut.</i>			
4.	A planifikohet dhe a realizohet vlerësimi i riskut dhe matja e burimeve të rrezatimit sipas legjislacionit në fuqi? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 5			
5.	A kryhen matjet dhe vlerësimi i riskut për burimet e rrezatimit artificial optik jo-koherent dhe/ose burimet artificiale të rrezatimit laser, në intervale një herë në vit ose një herë në çdo dy vjet në varësi të nivelit të ekspozimit në raport me Vlerën Kufi të Ekspozimit? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 5 dhe Shtojca I & II			
6.	A ndalohet puna e të miturve?			

	Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 4, 3.1 • Kur ekziston mundësia e ekspozimit ndaj rrezatimit laser (sidomos të emetuar nga laser të klasës 3B dhe 4) • Kur ekziston ekspozimi ndaj rrezatimit artificial ultravjollcë, si ai i emetuar gjatë saldimit dhe prerjes elektrike • Në afërsi të vendeve të punës me nxehtësi të madhe si furrat e shkrirjes së metalit, qelqit, etj.			
7.	A ndalohe puna e grave shtatzëna? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 4, 3.2 • Një ndalesë e tillë ndodh, nëse ekziston mundësia e ekspozimit ndaj rrezatimit laser (sidomos të emetuar nga laser të klasës 3B dhe 4); • Në afërsi të vendeve të punës me nxehtësi të madhe si furrat e shkrirjes së metalit, qelqit, etj.			
8.	A është siguruar që niveli i ekspozimit për gratë shtatzëna të mos tejkalojë ¼ e Vlerës Kufi të Ekspozimit për rrezatimin artificial ultravjollcë? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 4, 4			
9.	A janë metodat dhe aparaturat e përdorura për vlerësimin e riskut në përputhje me standardet aktuale evropiane dhe/ose ndërkombëtare? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 5, 3 • Ekipet inspektuese duhet të vërtetojë se aparaturat e përdorura për vlerësimin e riskut, janë në përputhje me standardet aktuale evropiane dhe/ose ndërkombëtare (IEC/EN, 60825-1 EN 14255-1, EN 14255-2, EN14255-3).			
10.	A janë përcaktuar veprimet e nevojshme teknike dhe organizative për të reduktuar rreziqet që vijnë nga ekspozimi			

	ndaj rrezatimit optik, në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 6, 1&2&4			
11.	A janë vendosur shenjat në vendet e punës ku punëmarrësit mund të ekspozohen ndaj niveleve të rrezatimit optik nga burime artificiale që tejkalojnë vlerat kufi të ekspozimit? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 6, 3			
12.	A është hartuar dhe a zbatohet një plan veprimi i cili përfshin masa teknike dhe organizative, nëse vlerësimi i riskut tregon një risk për punëmarrësit e ekspozuar ndaj burimeve natyrore të rrezatimit optik? Rregullore (MPMS) Nr .09/2017, Neni 6, 5			
13.	A është siguruar informimi dhe trajnimi i të punësuarve në përputhje me legjislacionin përkatës, për të punësuarit që ekspozohen ndaj rrezatimit optik në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 7			
14.	A bëhet konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarve në përputhje me legjislacionin përkatës? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 8			
15.	A është siguruar një mbikëqyrja shëndetësore periodik për ata punëmarrës që janë potencialisht të ekspozuar? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 9, 1			

16.	A është objekti i kontrolleve mjekësore i përshtatshëm me llojin dhe brezin e rrezatimit optik, të përcaktuar në Shtojcën III të rregullores Nr.09/2017? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 9, 2			
17.	A regjistrohen të dhënat nga mbikëqyrja shëndetësore për çdo punëmarrës në një formë të përshtatshme, që lejon konsultimin e tyre në një fazë të mëvonshme? Rregullore (MPMS) Nr.09/2017, Neni 9, 7			